

**Wurth-Kosova Shpk shpallë konkurs për:**

## **ASISTENT PRODUKT MENAXHER**

Jemi pjesë e koncernit botëror WÜRTH-GROUP dhe njëra nga kompanitë lidere në Republikën e Kosovës. Merremi me shitjen dhe distribuimin e produkteve për auto/cargo, metal, industri të drurit dhe ndërtimit (montim dhe elemente lidhëse për prodhim industrial, vegla të ndryshme dore, vegla elektrike, motorike ose me bateri, pajisje mbrojtëse, bulona, materiale shpenzuese për industrinë automobilistike, elemente lidhëse për moblieri dhe karpentieri, produkte teknike-kimike etj).

### **Profili dhe cilësitë tuaja:**

Keni kompetencë në fushat teknike (industrinë e makinerisë, elektroteknikës apo njohuri të produkteve kimike të këtyre industrive) dhe dëshironi të shkëmbeni njohuritë dhe përvojën tuaj? Po kërkon një punë sfiduese dhe posedoni karakteristikat e lartpërmendura? Atëherë, aplikoni në konkursin tonë për Asistent Produkt Menaxher.

### **Njohuritë dhe shkathhtësitë e dëshirueshme:**

- Kandidati të ketë të kryer shkollimin universitar: fakultetin e inxhinierisë mekanike ose ndërtimtarisë - arkitekturës. I vetë-motivuar për të punuar në një mjedis dinamik me mbikçyrje të limituar.
- Njohuri përdorimi të pakos softuerike MS Office - posaçërisht në Excel.
- Njohuri e asortimanit të produkteve të cilat kompanitë i përdorin në punën e tyre të përditshme në fushat si: mirëmbajtje e automjeteve dhe cargo, përpunim dhe mirëmbajtje metali, përpunim dhe mirëmbajtje druri si dhe produkte të ndryshme për përdorim në ndërtimtari.
- Aftësi të shkëlqyeshme organizative dhe të menaxhimit të kohës, njohuri shumë të mira të gjuhës angleze, aftësi komunikimi në të shkruar dhe në të folur.



### Përgjegjësitë tuaja në Würth:

Pas procesit orientues dhe trajnimit të vazhdueshëm, ju do të menaxhoni gamën e produkteve të divizionit përkatës, prezentoni, trajnioni stafin e shitjes për produktet standarde dhe produktet e reja, hulumtoni, analizoni dhe siguronit të dhëna mbi trendet aktuale të tregut dhe konform rezulteteve përkufizoni vendime strategjike për produktet e reja adekuate me qëllim të avancimit të shitjes së produkteve për industrinë e metalit, drurit dhe ndërtimtarisë.

### Te ne do të gjeni:

Zhvillim profesional, siguri dhe mjedis pune të shkëlqyer të nivelit ndërkombëtar, të ardhura personale konkurruese si dhe zhvillim në karrierë që varet direkt nga performansa, angazhimi dhe suksesi juaj.



Dërgoni CV-në tuaj në adresën [info@wurth-kosova.com](mailto:info@wurth-kosova.com) më së largu deri më: **07 shkurt 2021**.

Ju do të kontaktoheni nga departamenti i burimeve njerëzore të Würth-Kosova Shpk, vetëm nëse CV dhe dokumentet tuaja plotësuese përzgjedhen nga skuadra jonë e vlerësimit.